

EPPC Albania për klientin e saj, një *ndër kompanitë më të mëdha të importit dhe distribucionit, lider në industrinë e pijeve, me një histori suksesi në vend, rajon dhe më gjerë*, po kërkon një **Drejtor Shitjesh**.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e të gjithë skuadrës së shitjes, kontroll dhe zbatim të planeve javore dhe mujore sipas politikave të Shoqërisë;
- Në bashkëpunim me Bordin drejtues përgatit Planin Vjetor të shitjeve sipas distributorëve, bazuar në objektivat e Shoqërisë;
- Përpilon propozime konkrete për përmirësimin e shitjeve sipas zonave në on trade dhe off trade;
- Mirëmban marrëdhëniet me furnitorët dhe është në kontakt të vazhdueshëm me ta për cdo nevojë të tregut;
- Është pjesë e vendimarrjes për përfitimet komision dhe bonus performancë të distributorëve;
- Në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv harton dhe konfirmon oferta të nevojshme në periudha të caktuara, për evente dhe suporte të sygjera nga shitja;
- Mirëmban marrëdhëniet me distributorët;
- Krijon dhe zhvillon marrëdhënie me kategorinë e klientëve me të rëndësishëm dhe potencial në treg;
- Bën analiza tregu dhe cmimi për cdo produkt të ri potencial për tu punuar nga kompania;
- Analizon tregje të caktuara për distributorë dhe përfaqësues potencial në rast nevojë;
- Përpilon raporte periodike të shitjeve sipas kontratave me distributorët për shitjet javore dhe mujore;
- Mbi bazën e raporteve të shitjeve dhe informacioneve nga terreni propozon përmirësimin e politikave të shitjes sipas produkteve dhe zonave;
- Kontrolle në terren, për prezencën, çmimet, konkurrencën, bashkëpunim me distributorët për rritjen e shitjeve, monitorimin e punës së menaxherëve të shitjeve;
- Identifikon problematikat sipas zonave/distributorëve, konkurrencës dhe në bashkëpunim me strukturat e tjera në kompani propozon masa për përmirësimin e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të produkteve;
- Bashkëpunon me Marketingun për strategjinë në shërbim të shitjeve për implementim sipas periudhave të nevojshme;
- Përmirësim i sistemit të shitjeve në zona ku rezultatet janë të dobëta, me studime e propozime konkrete.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun e mëposhtëm:
<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.